

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT

EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 64/2012“Për Peshkimin”, të ndryshuar
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Konsultim
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm/transpozim i BE-së/ndërkombëtar
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Përafrim i legjislacionit të BE-së
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	<p>Rregullore e Këshillit (KE) Nr. 1224/2009 e datës 20 nëntor 2009, për krijimin e një sistemi kontrolli të Unionit për garantimin e përputhshmërisë me rregullat e politikës së përbashkët të peshkimit, duke ndryshuar Rregulloret (KE) Nr. 847/96, (KE) Nr 2371/2002, (KE) Nr. 811/2004, (KE) Nr. 768/2005, (KE) Nr. 2115/2005, (KE) Nr. 2166/2005, (KE) Nr. 388/2006, (KE) Nr. 509/2007, (KE) Nr. 676/2007, (KE) Nr. 1098 /2007, (KE) Nr. 1300/2008, (KE) Nr. 1342/2008 dhe shfuqizuar Rregulloret (KEE) Nr. 2847/93, (KE) Nr. 1627/94 dhe (KE) Nr. 1966/2006. Numri CELEX 32009R1224, Fletore Zyrtare, Nr. 343, dt. 22.12.2009, Faqe 1-50 Linku: http://data.europa.eu/eli/reg/2009/1224/oj</p> <p>Rregullore e Këshillit (KE) Nr. 1005/2008 e datës 29 shtator 2008, për vendosjen e një regjimi komunitar për të parandaluar, penguar dhe eliminuar peshkimin e paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar, që ndryshon Rregulloret (KEE) Nr. 2847/93, (KE) Nr. 1936/2001 dhe (KE) Nr. 601/2004 dhe që shfuqizon Rregulloren (KE) Nr. 1093/94 dhe (KE) Nr. 1447/1999. Numri CELEX 32008R1005, Fletore Zyrtare, Nr. 286, dt. 29.10.2008, Faqe 1-32 Linku: http://data.europa.eu/eli/reg/2008/1005/oj</p> <p>Rregullore (BE) Nr. 1380/2013 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 11 dhjetor 2013 mbi Politikën e Përbashkët të Peshkimit, që ndryshon Rregulloret e Këshillit (KE) Nr. 1954/2003 dhe (KE) Nr. 1224/2009 dhe që shfuqizon Rregulloret e Këshillit (KE) Nr.</p>

	2371/2002 dhe (KE) Nr. 639/2004 dhe Vendimin e Këshillit Nr. 2004/585/KE. Numri CELEX 32013R1380, Fletore Zyrtare, Nr. 354, dt. 28.12.2013, Faqe 22-61 Linku: http://data.europa.eu/eli/reg/2013/1380/oj
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Jo
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2024 – MBZHR- Nr. 3
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Marco Kule e-mail-i: marco.kule@bujqesia.gov.al numri i telefonit: Entela Kola e-mail-i: entela.kola@bujqesia.gov.al numri i telefonit: 0688535551 Arlinda Dedi e-mail-i:arlinda.dedi@bujqesia.gov.al numri i telefonit:
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT	
<p>Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030 përcakton se anëtarësimi i Shqipërisë në BE përbën objektivin kryesor kombëtar dhe qëllimin parësor strategjik të qeverisë.</p> <p>Ligji nr. 64/2012 “Për peshkimin”, i ndryshuar përaftron një numër Rregulloresh të BE. Disa nga këto rregullore janë shfuqizuar nga Rregullore të tjera të BE, sikurse ato që janë akoma në fuqi kane pësuar amendime dhe shtesa, një pjesë e të cilave duhet të reflekton edhe në ligjin nr. 64/2012 si dhe në aktet e tjera nënligjore. Megjithëse rregulloret e mësipërme janë shfuqizuar, konceptet janë mbartur në rregulloret e reja dhe riformulimi i neneve të propozuar në këtë draft ligj ka për qëllim rritjen e shkallës së përafrimit të tyre me Rregulloret përkatëse të BE.</p> <p>Gjatë procesit të screening, në shtator të vitit 2023 sikurse edhe në mbledhjet e zhvilluara midis Komisionit dhe Grupit të punës së kapitullit 13 u evidentuan disa përditësime që nevojiten në legjislacionin e peshkimit nga të cilat një pjesë e tyre kërkojnë ndryshimet e ligjit dhe pjesa tjetër do të ndryshohen në VKM –të përkatëse.</p> <p>Ligji nr. 42/2020 mbylli numrin e anijeve të peshkimit. Arsyeimi i mbylljes së numrit është i saktë pasi bazuar në vlerësimet e SAC (Scientific Advisory Committee) të GFCM , 60 % e burimeve të specieve tregtare në Mesdhe janë të mbi peshkuara dhe një pjesë e tyre është edhe në mbi peshkim. Në rastin e detit Adriatik, SAC ka këshilluar në mënyrë të përsëritur, se rezervat e merlucit, barbunit, karkalecit të thellësisë, çikales, skampi, sardeles, açugës janë mbi peshkuar dhe një pjesë e tyre janë në mbi peshkim, në nënzonën gjeografike FAO (GSAs) 17 dhe 18; (deti Adriatik). Natyrisht, falë politikave menaxhuese në drejtim të kufizimit të kapacitetit të peshkimit të vendeve të Mesdheut statusi i rezervave po</p>	

përmirësohet dhe vlera prej 60% është një përmirësim i dukshëm kundrejt 85% që ishte vetëm pak vite më pare.

Sot flota Shqiptare e peshkimit përbëhet nga 784 mjete lundruese, të cilat kategorizohen si Anije me tërheqje (Fundore) 194, Anije me rrethim (koshilok) 10, Draga hidraulike 5, Anije të peshkimit të vogël artizanal 556, Anije shumë përdorimshe (fundore dhe pelagjikë) 17.

Objektivat dhe prioritetet e Politikës së Përbashkët të Peshkimit të BE-së (Rregullore nr. 1380/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit në lidhje me Politikën e Përbashkët të Peshkimit) janë ndër të tjera: - Garantimi që aktivitetet e peshkimit dhe akuakulturës të jenë të qëndrueshme nga pikëpamja mjedisore, në periudhë afatgjatë dhe të menaxhohen në përputhje me arritjen e objektivave të përfitimeve ekonomike, sociale dhe të punësimit, sikurse kontribuojnë në disponueshmërinë e furnizimit me ushqim; - Zbatimi i qasjes së kujdesshme të menaxhimit të peshkimit, që ka për qëllim të sigurojë, shfrytëzimin e burimeve të gjalla detare biologjike dhe të shërbejë për mbajtjen e popullatave të specieve të zëna, mbi nivelet e afta, për të prodhuar rendimentin maksimal të qëndrueshëm; - Aplikimi i qasjes së bazuar në ekosistem, në menaxhimin e peshkimit, për të siguruar që aktivitetet e peshkimit të kenë një ndikim minimal negativ në ekosistemet detare dhe të sigurojnë që akuakultura dhe aktivitetet e peshkimit të shmangin degradimin e mjedisit detar.

Anijet shqiptare të peshkimit mund të zhvillojnë aktivitet jashtë Mesdheut dhe peshku i zënë kudo në botë është peshk shqiptar pasi varet nga flamuri i anijes së peshkimit. Që anijet të zhvillojnë aktivitet në detrat e largët, jashtë Mesdheut nevojitet që këto anije të jenë më të mëdha dhe të pajisura me aparataturat që mundësojnë lundrimin në distanca të largëta. Për këtë qëllim është e nevojshme të krijohet mundësia që ligji i peshkimit të lejojë futjen e anijeve të reja për peshkim jashtë Mesdheut, ashtu sikurse edhe vetë vendet e BE e kanë për flotën e tyre rregulloren e BE 2017/2403 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 12 dhjetor 2017 mbi menaxhimin e qëndrueshëm të flotës së jashtme të peshkimit dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 1006/2008. Këto anije do të mbahen në një regjistër të veçantë

Shqipëria është palë kontraktuese e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtën e Detit të 10 dhjetorit 1982 (UNCLOS), miratuar me ligjin Nr. 9055/2003. Kjo dispozitë ndërkombëtare përcakton parimin që të gjitha shtetet duhet të miratojnë masat e duhura për të siguruar menaxhimin dhe ruajtjen e qëndrueshme të burimeve detare dhe për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin për këtë qëllim.

Shqipëria ka pranuar Marrëveshjen për të nxitur respektimin e masave ndërkombëtare të ruajtjes dhe menaxhimit nga anijet e peshkimit në det të hapur të 24 nëntorit 1993 të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë, miratuar me ligjin Nr. 9401/2005. Kjo Marrëveshje parashikon që një palë kontraktuese nuk duhet të lëshojë leje për të përdorur një anije për peshkim në det të hapur nëse disa kushte nuk plotësohen, si dhe të zbatojë sanksione nëse disa detyrime raportimi nuk përmbushen.

Shqipëria ka miratuar Planin Ndërkombëtar të Veprimit të FAO-s për të parandaluar, penguar dhe eliminuar peshkimin e paligjshëm, të paraportuar dhe të padeklaruar ('IPOA-IUU') të miratuar në vitin 2001. IPOA-IUU dhe Udhëzimet Vullnetare të FAO-s për performancën e shtetit të flamurit të miratuara në 2014 nënvizojnë përgjegjësinë e shtetit flamur për të siguruar ruajtjen afatgjatë dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve të gjalla detare dhe ekosistemeve detare. IPOA-IUU parashikon që një shtet flamur duhet të lëshojë leje/autorizime për të peshkuar në ujërat jashtë sovranitetit ose juridiksionit të tij për anijet që mbajnë flamurin e tij.

Shqipëria nuk ka miratuar Marrëveshjen e Kombeve të Bashkuara për zbatimin e dispozitave të Konventës së 10 dhjetorit 1982 në lidhje me ruajtjen dhe menaxhimin e stoqeve të peshqve të nder zonalë dhe rezervave të peshqve shumë migrues. Për këtë qëllim nuk mund të lëshojë leje peshkimi për anijet në det të hapur që peshkojnë këto popullata peshqish.

Parimi kryesor i kësaj ndërhyrjeje është që çdo anije shqiptare që peshkon jashtë ujërave territoriale duhet të pajiset me leje dhe rrjedhimisht t'i nënshtrohet mbikëqyrjes nga shteti

shqiptar, flamurin e të cilit anija mban, kudo që operon dhe pavarësisht nga kuadri në të cilin zhvillohen aktivitetet e tij. Dhënia e një leje peshkimi duhet t'i nënshtrohet pajtueshmërisë me një sërë kriteresh të përshtatshmërisë.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Strategjia e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021-2027 përcakton si Objektiv të përgjithshëm: “Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm të peshkimit detar dhe të ujërave të brendshme” e cila bazohet në objektivin e Zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ) të Agjendës së OKB 2030 (OZHQ 14), për të ruajtur dhe përdorur në mënyrë të qëndrueshme Detin Mesdhe dhe burimet detare për zhvillim të qëndrueshëm.

Objektivat specifike janë:

1. Ruajtja e rezervave të peshkut dhe reduktimi i mbi peshkimit në mënyrë që t'u ofrohet qytetarëve një furnizim afatgjatë i qëndrueshëm, i sigurt dhe i shëndetshëm me ushqim;
2. Mbështetjen e përpunimit dhe tregtimit të produkteve të peshkimit për ofrimin e ushqimit me cilësi të lartë, të sigurt, ushqyes dhe të qëndrueshëm, si dhe informacion për konsumatorin;
3. Mbështetjen e peshkimit në shkallë të vogël dhe shfrytëzimin racional të burimeve të rinovueshme, si dhe qëndrueshmërinë e tyre afatgjatë;
4. Mbështetjen për zhvillimin e kapaciteteve të strukturave institucionale dhe administrative;
5. Mbështetjen e mbikëqyrjes, kontrollit, zbatimit, shkëmbimit të informacionit dhe aktiviteteve të bashkëpunimit në peshkim në detin Adriatik;
6. Mbrojtjen dhe rivendosjen e biodiversitetit dhe ekosistemeve detare dhe bregdetare, e cila është një sfidë kryesore për të pasur dete dhe oqeanë të shëndetshme;
7. Mbështetjen për përafrimin me acquis të BE-së (kapitulli 13) në peshkim dhe Politikën e Përbashkët të Peshkimit.

Ky Propozim është në përputhje me objektivin e përgjithshëm dhe objektivat specifike “1”, “4” dhe “5” të strategjisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021-2027. Gjithashtu është në përputhje me vizionin e përcaktuar në *Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030 që të bëjë të mundur një sektor agro-ushqimor dhe të peshkimit të efektshëm, inovativ dhe të qëndrueshëm, i cili mund të përballojë sfidat afatmesme dhe afatgjata që lidhen me sigurimin e ushqimit dhe të reagojë ndaj sfidave të ndryshimeve klimatike, menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe biodiversitetit; ndërkohë që kontribuon në rritjen e të ardhurave dhe përmirësimin dhe cilësisë se jetës.*

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Për arritjen e objektivave të politikës janë shqyrtuar opsionet e mëposhtme:

- **Opsioni 0 (status quo):** - Nuk do të ndërhyjmë me ndryshim apo politikë të re.

Procesi i përafrimit të legjislacionit është një prioritet i Qeverisë shqiptare. Gjetjet nga procesi i screening dhe reflektimi i tyre nëpërmjet sa më shpejt është një prioritet i cili ndihmon në transformimin e sektorit me standarde më të larta duke garantuar edhe qëndrueshmërisë e tij. Në këtë kontekst mbajtja e status quo sjell një vonesë në këtë proces kaq të rëndësishëm.

- **Opsioni 1:** Ndryshimi i ligjit ekzistues;

Ndryshimi i ligjit Nr. 64/2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar do të prekte propozuar prek vetëm disa nene të ligjit. Ky ndryshim nuk prek thelbin e ligjit dhe mundëson përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit duke shmangur problematiken e paraqitur në opsionin 1.

Përveç procesit të përafrimit, gjithashtu ndryshimi i propozuar ligjit do të mundësonte zhvillimin e mëtejshëm të sektorit të peshkimit dhe kjo natyrisht lidhet me të gjithë zinxhirin deri në përpunim. Rritja e sasisë së peshkut të zënë do të reflektohet kryesisht në rritjen e eksporteve “made in Albania”. Deti Mesdhe, përgjithësisht është një det me pak resurse peshkore dhe përgjithësisht me këto resurse të mbi peshkuara. Zonat kryesore në botë të cilat për arsye natyrore dhe të një kombinimi të shumë faktorëve oqeanografike shquhen për një bollëk të resurseve peshkore do të jenë një mundësi rritjeje të sektorit të peshkimit, të eksporteve shqiptare dhe të të ardhurave në ekonominë vendase.

- **Opsioni 2:** Hartimi i një ligji të ri “Për peshkimin”.

Ligji nr. 64/2012 “Për Peshkimin” i ndryshuar, është një ligj, i cili bazohet në 10 akte të Bashkimit Evropian dhe i përafruar me këto akte. Që nga viti 2012 ligji ka pësuar ndryshime, duke ndjekur ndryshimet e Rregulloreve përkatëse të Parlamentit dhe Këshillit Evropian dhe duke ruajtur shkallën e tij të përafrimit. Thelbi i Rregulloreve, mbi të cilat ai bazohet nuk ka ndryshuar dhe si i tillë edhe thelbi i këtij ligji nuk ndryshon. Rregulloret bazë si nr.1224/2009, nr.1967/2006, nr.1005/2008, janë akoma shtyllat e legjislacionit komunitar, me gjithë ndryshimet që kanë pësuar në vite.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Ndikimet ekonomike të opsionit të preferuar (Opsioni 1). Kostot e drejtpërdrejta për sektorin publik. Ky projektligj nuk ka kosto të drejtpërdrejta në buxhetin e shtetit. Anijet e reja do të jenë investim privat të cilat kapin vlerën e disa miliona €/për anije. Anijet shqiptare të peshkimit mund të zhvillojnë aktivitet jashtë Mesdheut dhe peshku i zënë kudo në botë është peshk shqiptar pasi origjina e peshkut varet nga flamuri i anijes së peshkimit. Që anijet të zhvillojnë aktivitet në detrat e largët, jashtë Mesdheut nevojitet që këto anije të jenë më të mëdha dhe të pajisura me aparaturat që mundësojnë lundrimin në distanca të largëta. Rritja e sasive të zëna do të sjellë rritjen e eksporteve dhe rritjen e përpunimit në vend me ndikim në punësim.

Ndikimi mjedisor i drejtpërdrejtë. Një nga politikat e përcaktuara në SKZHIE për bujqësinë dhe zhvillimin Rural është *Zhvillimi i qëndrueshëm i peshkimit dhe ekonomisë blu*; Objektivat e Përgjithshëm janë ndër të tjera: Forcimi i menaxhimit të qëndrueshëm të

burimeve natyrore dhe veprimeve lidhur me klimën dhe. Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm detar dhe të ujërave të brendshme; Projekt ligji shton speciet e mbrojtura si dhe ndalon disa praktika, që edhe pse nuk përdoren në Shqipëri, i parandalon ato në të ardhmen, jo vetëm në ujërat shqiptare por kudo që anijet zhvillojnë ose do të zhvillojnë aktivitetet.

Qëllimi i këtij projektligji është zhvillimi i sektorit në mënyrë të qëndrueshme sikurse forcimi i masave menaxhuese për flotën e peshkimit. Projekt ligji gjithashtu përkufizon zonat e kufizuara të peshkimit (Fisheries Restricted Area, FRA).

Ndikimi Social i drejtpërdrejtë.

Një biznes i suksesshëm është garanci në ruajtjen e vendeve të punës dhe të një zhvillimi afatgjatë. Rritja e prodhimit do të sjellë efekte në punësim nëpërmjet përpunimit të prodhimeve peshkore. Zhvillim i qëndrueshëm do të thotë një garanci në ruajtjen e vendeve të punës në të gjithë zinxhirin e sektorit.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opcionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni i preferuar është përzgjedhur Opsioni 1 (ndryshimi i ligjit), që synon disa rregullime në aktivitetin e peshkimit, në kuadër të një qasje më të afërt, me fusha të rëndësishme të Politikës së Përbashkët të Peshkimit, të Bashkimit Evropian, dokumentit programatik të Unionit për mbështetjen dhe zhvillimin e sektorit të peshkimit dhe akuakulturës, nëpërmjet një balancimi midis gjendjes së burimeve dhe kapaciteteve të peshkimit.

Projektligji siguron një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit, duke garantuar vlerën e investimeve të kryera në flotën e peshkimit si dhe vazhdimin e suksesshëm të biznesit të peshkimit detar. Sektori i peshkimit detar, do të vazhdojë rritjen dhe nivelin e investimeve, të drejtuara në përmirësimin e anijeve të peshkimit ose në anije të reja të afta për të peshkuar në detet e hapura.

Kostoja e përlloritur në total e opcionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3
0	0	0

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?)

Projektligji është konsultuar në Komisionin Konsultativ qendror, “Për peshkimin dhe Akuakulturën” (KKQPA), të ngritur sipas nenit 21 të ligjit nr.64/2012 “Për peshkimin” i ndryshuar dhe ka marrë miratimin e këtij Komisioni. Në përbërje të këtij komisioni, përveç përfaqësuesve të Ministrisë, ekspertë të fushës, akademikë, ka edhe përfaqësues të biznesit në fushën e akuakulturës. Peshkimi në detet e hapur është një kërkesë e biznese të peshkimit të cilët kane kërkuar të zhvillojnë aktivitetin në ujërat ndërkombëtare, atje ku operojnë edhe anijet e vendeve të tjera.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Zbatimi dhe monitorimi do të realizohen sipas përcaktimeve të dispozitave të projektligjit. Autoritetet vendimmarrëse, për çështjet e peshkimit janë të përcaktuara në ligjin e peshkimit.

Pajisja e me leje per anijet e peshkimit ne detet e hapura është një mënyrë për monitorimin e aktivitetit të tyre. Anijet e peshkimit janë dhe do të jenë të pajisura me VMS me monitorim satelitor i cili monitoron aktivitetin e anijeve të peshkimit kudo që ato ndodhen.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Strategjia e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021-2027 përcakton si Objektiv të përgjithshëm: “Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm të peshkimit detar dhe të ujërave të brendshme” e cila bazohet në objektivin e Zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ) të Agjendës së OKB 2030 (OZHQ 14), për të ruajtur dhe përdorur në mënyrë të qëndrueshme Detin Mesdhe dhe burimet detare për zhvillim të qëndrueshëm. Objektivat specifike janë: Ruajtja e rezervave të peshkut dhe reduktimi e mbi peshkimit në mënyrë që t'u ofrohet qytetarëve një furnizim afatgjatë i qëndrueshëm, i sigurt dhe i shëndetshëm me ushqim.

Ky objektiv është në përputhje me objektivat dhe prioritetet e BE-së si dhe Politikës së Përbashkët të Peshkimit (PPP).

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian si dokumenti bazë strategjik i Republikës së Shqipërisë përcakton se vizioni i Republikës së Shqipërisë është “*Shqipëria 2030: Një ekonomi dinamike, pjesë e Bashkimit Evropian dhe rajonit, që ofron kushte të barabarta për rritjen e mirëqenies së të gjithë qytetarëve të saj mbështetur në një demokraci funksionale që garanton të drejtat themelore dhe liritë e njeriut*”. Ky vizion do të arrihet përmes politikave dhe përparësive që synojnë transformimin e gjithanshëm të Shqipërisë drejt një vendi me standarde që mundësojnë anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

Ligji nr. 64/2012 “Për peshkimin”, i ndryshuar përafrohet një numër Rregulloresh të BE, Rregulloren e Këshillit nr. 1224/2009/KEE, Rregulloren e Këshillit nr. 2371/2002/KE, Rregulloren e Këshillit nr. 1967/2006/KE, Rregulloren e Këshillit nr. 1198/2006/KE Rregulloren e Këshillit nr. 1005/2008/KE, Rregulloren e Këshillit nr. 104/2000/KE etj.

Disa nga këto rregullore janë shfuqizuar nga Rregullore të tjera të BE-së, sikurse ato që janë akoma në fuqi kanë pësuar amendime dhe shtesa, një pjesë e të cilave duhet të reflekton edhe në ligjin nr. 64/2012 si dhe në aktet e tjera nënligjore. Kështu, Rregullorja e Këshillit nr. 2371/2002/KE është shfuqizuar nga Rregullorja (BE) Nr. 1380/2013 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 11 dhjetor 2013 mbi Politikën e Përbashkët të Peshkimit, që ndryshon Rregulloret e Këshillit (KE) Nr. 1954/2003 dhe (KE) Nr. 1224/2009 dhe që shfuqizon Rregulloret e Këshillit (KE) Nr. 2371/2002 dhe (KE) Nr. 639/2004 dhe Vendimin e Këshillit Nr. 2004/585/KE.

Po kështu Rregullorja e Këshillit nr. 104/2000/KE është shfuqizuar nga Rregullorja (BE) nr. 1379/2013 i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit, i datës 11 dhjetor 2013, lidhur me organizimin e përbashkët të tregjeve në sektorin e produkteve të peshkimit dhe akuakulturës, që ndryshon Rregulloren (KE) nr. 1184/2006 dhe (KE) nr. 1224/2009 të Këshillit dhe shfuqizimin e Rregullos (KE) nr. 104/2000 të Këshillit. Gjithashtu, Rregullorja (BE) Nr. 1224/2009 është amenduar ku disa nene janë ndryshuar dhe shtuar disa nene të tjerë.

Megjithëse rregulloret e mësipërme janë shfuqizuar, konceptet janë mbartur në rregulloret e reja por nevojitet rritja e e shkallës së përafritimit të legjislacionit me Rregulloret përkatëse të BE.

Gjatë procesit të screening për Kapitullin 13, në shtator të vitit 2023 sikurse edhe në mbledhjet e zhvilluara midis Komisionit dhe Grupit të punës së Kapitullit 13 u evidentuan disa përditësime që nevojiten në legjislacionin e peshkimit nga të cilat një pjesë e tyre kërkojnë ndryshimet e ligjit dhe pjesa tjetër do të ndryshohen në VKM –të përkatëse.

Shqipëria ka miratuar Planin Ndërkombëtar të Veprimit të FAO-s për parandalimin, pengimin dhe eliminimin e peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar ('IPOA-IUU') të

miratuar në vitin 2001. IPOA-IUU, së bashku me Udhëzimet Vullnetare të FAO-s për sjelljen e shteteve flamur të miratuar në 2014, përcakton përgjegjësinë e shtetit të flamurit për të siguruar ruajtjen afatgjatë dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve biologjike detare dhe ekosistemeve detare. Sipas IPOA-IUU, shteti i flamurit duhet të lëshojë leje/autorizime për anijet që mbajnë flamurin e tij për të peshkuar në ujërat që nuk janë nën sovranitetin ose juridiksionin e tij.

Shqipëria është palë e Marrëveshjes për nxitjen e respektimit të masave ndërkombëtare të menaxhimit dhe të ruajtjes së burimeve nga anijet e peshkimit në det të hapur, miratuar me ligjin Nr. 9401, datë 19.5.2005. Sipas kësaj marrëveshjeje, palët kontraktuese nuk mund të autorizojnë përdorimin e anijeve për peshkim në det të hapur nëse disa kushte nuk plotësohen dhe duhet të miratojnë sanksione në rast të mospërbushjes së detyrimeve të caktuara raportuese.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Ligji nr. 64/2012 “Për peshkimin”, i ndryshuar, megjithëse është i përafuar me legjislacionin e BE, ka nevojë të përditësohet duke ndjekur ndryshimet e rregulloreve përkatëse të BE dhe/ose përditësimet e tyre. Anëtarësimi i Shqipërisë në BE përbën objektivin kryesor kombëtar dhe qëllimin parësor strategjik të qeverisë. Me hapjen e negociatave për vendin dhe përfundimin e procesit të screening, fillon një fazë e re për integrimin e vendit në BE. Ky integrim do të arrihet duke siguruar:

- Nxitjen e ritmeve të zhvillimit të vendit, duke gjeneruar rritje ekonomike të qëndrueshme, përmes një stabiliteti makroekonomik dhe financiar;
- Arritjen e standardeve që u shërbejnë qytetarëve, rritjes së mirëqenies dhe sigurimit të mbrojtjes së të drejtave të tyre;
- Transformimin e Shqipërisë në një vend me standarde, që mundësojnë anëtarësimin në Bashkimin Evropian;
- Ndërtimin e politikave që rrisin konkurrueshmërinë dhe rritjen ekonomike të vendit, krahasuar me vendet e rajonit dhe më tej.

Neni 70 i MSA përcakton: *Palët njohin rëndësinë e përafrimit të legjislacionit ekzistues shqiptar me atë të Komunitetit dhe zbatimin e tij me efektivitet. Shqipëria do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojë gradualisht drejt përputhjes me acquis e Komunitetit. Shqipëria do të sigurojë që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet dhe imponohet si duhet.*

Ky proces do të ketë ndikim në të gjithë shoqërinë shqiptare dhe në rastin në fjalë do të jenë të përfshira qeveria, bizneset, qytetarët si pjese e një procesi transformues të Shqipërisë.

Përafrimi i legjislacionit ndikon në të gjithë shoqërinë shqiptare duke prekur çdo qelize të saj, që nga pushteti qendror dhe ai vendor, bizneset dhe shoqërinë civile dhe vetë qytetarët.

Gjithashtu, përafrimi i legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian, dhe zbatimi i plotë dhe efektiv i tij, janë një nga kriteret e Kopenhagës për anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Prosesi i negociatave të anëtarësimit është në vetvete procesi i përafrimit të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian, si dhe i përmbushjes së piketave hapëse, të ndërmjetme dhe mbyllëse të negociatave të anëtarësimit dhe kriterëve për anëtarësim.

Arsyeja e ndërhyrjes

- Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.
- Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.
- Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.
- Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.
- Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.

Ndërhyrja me këtë projektligj është e nevojshme, për arsye të procesit të përafrimit të legjislacionit me *Aquis* të BE si dhe krijimi i mundësisë të zhvillimit të mëtejshëm të këtij sektori duke e orientuar në drejtim të deteve të hapura.

Ky projektligj bën pjese në PKIE (Plani Kombëtar për Integrimin Evropian) i cili ka si synim të adresojë përmes masave të politikës (dokumente strategjike) dhe ligjore, institucionale dhe zbatuese linjëzimin e kuadrit rregullator vendas me *acquis* të BE-së, si dhe zbatimin efektiv të tij.

Anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian mbetet objektivi kryesor strategjik i Republikës së Shqipërisë. Qeveria shqiptare në programin e saj qeverisë ka përcaktuar se “*Evropa e Bashkuar është busulla jonë dhe familja natyrale të cilës i përkasim, por ku ende mungojmë*”.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian si dokumenti bazë strategjik i Republikës së Shqipërisë përcakton se vizioni i Republikës së Shqipërisë është “*Shqipëria 2030: Një ekonomi dinamike, pjesë e Bashkimit Evropian dhe rajonit, që ofron kushte të barabarta për rritjen e mirëqenies së të gjithë qytetarëve të saj mbështetur në një demokraci funksionale që garanton të drejtat themelore dhe liritë e njeriut*”. Ky vizion do të arrihet përmes politikave dhe përpalesive që synojnë transformimin e gjithanshëm të Shqipërisë drejt një vendi me standarde që mundësojnë anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

Objektivi i politikës

- Vendosi objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.
- Sigurohuni që objektivat janë specifikë, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.

Kjo politikë e propozuar synon përmbushjen e objektivave të mëposhtme:

- Zhvillimi i sektorit të peshkimit detar mbështetur në një menaxhimi të qëndrueshëm të burimeve peshkore detare;
- Një flotë detare e suksesshme dhe konkurruese në ekuilibër me disponueshmërinë e burimeve të peshkimit;

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- Përshkruani opsionin e status quo-së.
- Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.
- Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.

Gjatë analizës që është kryer nga MBZHR, janë shqyrtuar tre opsionet e mëposhtme:

- Opsioni i status quo-së (0):

Opsioni i parë është mos ndërhyrja e qeverisë dhe vijimi në të njëjtat kushte duke pritur që situata të vetërregullohet. Procesi i përafrimit të legjislacionit është një prioritet i Qeverisë shqiptare. Gjetjet nga procesi i screening dhe reflektimi i tyre nëpërmjet sa më shpejt është një prioritet i cili ndihmon në transformimin e sektorit me standarde më të larta duke garantuar edhe qëndrueshmërisë e tij. Në këtë kontekst mbajtja e *status quo* sjell një vonesë në këtë proces kaq të rëndësishëm.

- Opsioni 1: Ndryshimi i ligjit ekzistues.

Ndryshimi i ligjit nr. 64/2012 “Për peshkimin”, i ndryshuar, do të prekte vetëm disa nene të dhe jo thelbin e ligjit duke mundësuar përafrimin e mëtejshëm të legjisllacionit dhe për rrjedhojë duke shmangur problematikën e paraqitur në opsionin 0.

Përveç procesit të përafrimit, gjithashtu ndryshimi i propozuar mundëson zhvillimin e mëtejshëm të sektorit të peshkimit dhe kjo natyrisht lidhet me të gjithë zinxhirin deri në përpunim. Rritja e sasisë së peshkut të zënë do të reflektohet kryesisht në rritjen e eksporteve “made in Albania”. Deti Mesdhe, përgjithësisht është një det me pak resurse peshkore dhe përgjithësisht me këto resurse të mbi peshkuara. Zonat kryesore në botë të cilat për arsye natyrore dhe të një kombinimi të shumë faktorëve oqeanografike shquhen për një bollëk të resurseve peshkore do të jenë një mundësi rritjeje të sektorit të peshkimit, të eksporteve shqiptare dhe të të ardhurave në ekonominë vendase.

- Opsioni 2: Hartimi i një Ligji të ri për peshkimin.

Ligji nr. 64/2012 “Për Peshkimin”, të ndryshuar është një ligj, i cili bazohet në 10 akte të Bashkimit Evropian. Ky ligj është i përafruar me aktet në të cilat ai bazohet. Që nga viti 2012 ligji ka pësuar ndryshime, duke ndjekur ndryshimet e Rregulloreve përkatëse të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, duke ruajtur shkallën e tij të përafrimit. Thelbi i Rregulloreve mbi të cilat ai bazohet, nuk ka ndryshuar dhe si i tillë edhe thelbi i këtij ligji nuk ndryshon. Rregulloret bazë si nr.1224/2009, nr.1967/2006, nr.1005/2008, janë akoma shtyllat e legjisllacionit komunitar, me gjithë ndryshimet që kanë pësuar në vite. Për këto arsye gjykohet që ligji është në përputhje me Politiken e Përbashkët të Peshkimit të BE-së dhe nuk lind nevoja e hartimit të një ligji të ri, por vetëm përditësimi i tij.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
 - *Paraqisni përlogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Grupet e prekura nga kjo nismë janë:

- Subjektet, pronarë të anijeve të peshkimit;
- Konsumatori.

Ndikimet e drejtpërdrejta

Ndikimet ekonomike

Ky projektligj nuk ka kosto të drejtpërdrejta në buxhetin e shtetit. Anijet e reja do të jenë investim privat të cilat kapin vlerën e disa miliona €/për anije. Anijet shqiptare të peshkimit mund të zhvillojnë aktivitet jashtë Mesdheut dhe peshku i zënë kudo në botë është peshk shqiptar pasi origjina e peshkut varet nga flamuri i anijes së peshkimit. Që anijet të zhvillojnë aktivitet në detrat e largët, jashtë Mesdheut nevojitet që këto anije të jenë më të mëdha dhe të pajisura me aparaturat që mundësojnë lundrimin në distanca të largëta. Rritja e sasive të zëna do të sjellë rritjen e eksporteve dhe rritjen e përpunimit në vend me ndikim në punësim.

Ndikimet sociale

Një biznes i suksesshëm është garanci në ruajtjen e vendeve të punës dhe të një zhvillimi afatgjatë. Rritja e prodhimit do të sjellë efekte në punësim nëpërmjet përpunimit të prodhimeve peshkore. Zhvillim i qëndrueshëm do të thotë një garanci në ruajtjen e vendeve të punës në të gjithë zinxhirin e sektorit.

Ndikimet mjedisore

Një nga politikat e përcaktuara ne SKZHIE për bujqësinë dhe zhvillimin Rural është *Zhvillimi i qëndrueshëm i peshkimit dhe ekonomisë blu*; Objektivat e Përgjithshëm janë ndër të tjera: Forcimi i menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe veprimeve lidhur me klimën dhe Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm detar dhe të ujërave të brendshme; Projektligji shton speciet e mbrojtura si dhe ndalon disa praktika, që edhe pse nuk përdoren në Shqipëri, i parandalon ato në të ardhmen, jo vetëm në ujërat shqiptare por kudo që anijet zhvillojnë ose do të zhvillojnë aktivitet.

Qëllimi i këtij projektligji është zhvillimi i sektorit në mënyrë të qëndrueshme sikurse forcimi i masave menaxhuese për flotën e peshkimit. Projektligji gjithashtu përkufizon zonat e kufizuara të peshkimit (Fisheries Restricted Area, FRA).

Ndikimet jo të drejtpërdrejta

Ndikimet ekonomike

Ky projektligj nuk ka ndikime të drejtpërdrejta në buxhetin e shtetit.

Nga ana tjetër, ky projektligj siguron një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit, duke orientuar investimet për anije të afta të peshkojnë në zonat më të pasura me peshk dhe rritur eksportet shqiptare. Rritja e sektorit do të sjellë një vlerë të shtuar për ekonominë shqiptare.

Ndikimet mjedisore

Nuk parashikohen ndikime jo të drejtpërdrejta mjedisore. Zhvillimi i aktivitetit të peshkimit në detet e hapura do të kryhet në zbatim të të gjitha marrëveshjeve ndërkombëtare dhe në zbatim të planeve të menaxhimit të hartuara dhe në fuqi nga Organizatat rajonale të Menaxhimit të Peshkimit. .

Ndikimet sociale

Nuk maten ndikime jo të drejtpërdrejta sociale, përveç faktit se nëpërmjet ndryshimeve që dikton projektligji krijon mundësitë e rritjes së punësimit.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni i preferuar është hartimi dhe miratimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 64/2012 “Për Peshkimin”, i ndryshuar pasi bazuar në analizën e dispozitave dhe neneve që ndryshohen u arrit në përfundimin se nuk është e nevojshme të hartohet një ligji i ri, pasi në fillim është bërë analiza e vlerësimit të boshllëqeve ligjore, nëpërmjet të cilit u identifikuan ndërhyrjet që duheshin bërë.

Ky opsion përcakton zhvillimin e qëndrueshëm të peshkimit detar, krijon kushte për zhvillim të kësaj industrie, nëpërmjet investimeve të biznesit vendas, të cilat kanë të garantuar një biznes afatgjatë.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Zbatimi do të realizohet, sipas përcaktimeve të kësaj iniciative ligjore.

Autoritetet përgjegjëse për zbatimin e ndryshimit të ligjit për peshkimin do të jenë:

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është njësia përgjegjëse, për monitorimin e zbatueshmërisë së Ligjit, pas miratimit të këtij propozimi.

Komisioni i Lejeve të Peshkimit i ngritur me urdhër ministri si dhe të gjitha institucionet e përfshira në dhënien e lejeve si QKB dhe në platformën qeveritare e-Albania etj. Gjithashtu do të jene të përfshira edhe inspektorati i peshkimit dhe QNOD të cilat monitorojnë aktivitetin e anijeve të peshkimit kudo që ato ndodhen.

Anijet për t’u pajisur me leje peshkimi, duhet të plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në VKM nr. 538/2009 dhe kjo procedurë realizohet prej 10 vjetësh pa asnjë problem. Subjektet për pajisje me leje peshkimi duhet të aplikojnë te portali e- Albania. Bazuar në Urdhrin Nr. 438, datë 26/12/2019, “Për procedurat e regjistrimit, licencimit dhe publikimit në mënyrë elektronike”, nga data 01/01/2020, shërbimi i aplikimit për pajisje me licencë/leje do të ofrohen, vetëm në mënyrë elektronike, nëpërmjet sportelit elektronik në portalin e-Albania, në përputhje me ligjin për licencimin e biznesit, ligjin për nënshkrimin elektronik dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre.

Shqipëria është palë e Marrëveshjes për nxitjen e respektimit të masave ndërkombëtare të menaxhimit dhe të ruajtjes së burimeve nga anijet e peshkimit në det të hapur, miratuar me ligjin Nr. 9401, datë 19.5.2005. Sipas kësaj marrëveshjeje, palët kontraktuese nuk mund të autorizojnë përdorimin e anijeve për peshkim në det të hapur nëse disa kushte nuk plotësohen dhe duhet të miratojnë sanksione në rast të mospërbushjes së detyrimeve të caktuara raportuese.

Subjekti për tu pajisur me një licencë dhe/ose leje, paraqet kërkesën nëpërmjet sportelit elektronik në portalin e-Albania, dhe plotëson formularin e aplikimit duke dorëzuar dokumentet e nevojshme për të provuar përmbushjen e licencimit që hartohen prej tij dhe/ që nuk lëshohen nga institucionet shtetërore. Ndërsa, dokumentet e tjera që provojnë përmbushjen e licencimit, por që lëshohen nga institucionet shtetërore, do të sigurohen nga QKB.

Pas përfundimit të procesit të aplikimit, aplikimi së bashku me dokumentacionin përkatës i dërgohet QKB, për të vazhduar procesin e shqyrtimit të aplikimit. Ky dokumentacion më pas nga QKB, i dërgohet MBZHR, e cila merr vendimin dhe përgatit aktin e miratimit.

1. **Përcaktimi i kriterëve që tregojnë arritjen e objektivit** Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve peshkore detare, nëpërmjet një kontrolli efektiv dhe mbështetje me të dhënat shkencore të sakta:

- Efektiviteti në kontrollin e numrit të lejeve të peshkimit
- Ekuilibër i siguar midis lejeve dhe disponueshmërisë së burimeve të peshkimit
- Efektivitet dhe mbështetje me të dhënat shkencore
- Shkalla e riskut të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve peshkore, detare;
- Kostot.

2. **Vendosja e peshës së kriterëve sipas rëndësisë relative**

- Efektiviteti në kontrollin e numrit të lejeve të peshkimit : 5;
- Ekuilibër i siguar midis lejeve dhe disponueshmërisë së burimeve të peshkimit 3;
- Efektivitet dhe mbështetje me të dhënat shkencore:4;
- Shkalla e riskut të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve peshkore, detare: 5
- Kostot: 2.

3. Përcaktimi i **shkallës së performancës** nëpërmjet intervalit të pikëve nga 0 – 5.

4. **Vendosja e pikëve të opsioneve** përkundrejt secilit kriter sipas matricës së mëposhtme.

Matrica e performancës:

Kriteret	Pesha (Rëndësia relative)	Opsioni 0		Opsioni 1		Opsioni 2	
		Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)	Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)	Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)
Efektiviteti në kontrollin e numrit të lejeve të peshkimit	5	0	0	5	25	1	5
Ekuilibër i siguar midis lejeve dhe disponueshmërisë së burimeve të peshkimit	3	0	0	3	9	3	9
Efektivitet dhe mbështetje me të dhënat shkencore	4	1	4	5	20	4	16
Shkalla e riskut të të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve peshkore, detare	5	6	30	1	5	1	5
Kostot	2	1	2	2	4	4	8
Pikët totale për secilin opsion			36		63		43

Analiza me shumë kriteret tregon se opsioni 1 (ndryshimi i ligjit ekzistues nr. 64/2012 “Për peshkimin“, i ndryshuar) është vlerësuar me më shumë pikë dhe ne e kemi zgjedhur atë si opsionin tonë të preferuar.

Kjo nuk prek thelbin e ligjit. Ndryshimet mundësojnë shmangien e problemit të paraqitur me qëllim zhvillimin aktivitetit të anijeve të peshkimit tregtar dhe profesional në detet e hapura duke mundësuar rritjen e prodhimit dhe të eksporteve shqiptare.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.
- Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.

Ky proces do të jetë 100% transparent dhe i hapur. Publikimi i listës së anijeve të peshkimit me numër NFR, si dhe ndjekja on-line e të gjitha hapave, nëpërmjet portalit e-Albania, mundëson përgjigje brenda afateve ligjore të parashikuara, i monitorueshëm në çdo hap të procesit, jo vetëm nga institucionet e ngarkuara për këtë qëllim, por edhe nga çdo i interesuar. Një nga elementet bazë të shërbimeve on - line është monitorimi i procesit dhe transparenca e tij. Tregues të funksionimit të këtij procesi është shpejtësia e ofrimit të shërbimit.

Njësia zbatuese është Komisioni i dhënies së lejeve të peshkimit i ngritur me urdhër ministri. Ky proces është i monitorueshëm.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – një herë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – një herë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – një herë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total										
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e kostos në total										

Vlera aktuale e përfitimit në total	
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total	

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			